

VENDIM
Nr. 325, datë 14.12.2022

MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 74, DATË 13.4.2022, “MBI VLERËSIMET E ERE-s PËR KOSTOT E AKTIVITETIT TË FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL, PËR PERIUDHËN 1.5.2022–31.12.2022”

Në mbështetje të neneve 16, 19, 20, germa “c”, 83 dhe 85, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; neneve 15, 19, pika 1, germa “c” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit Transmetimit të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 180, datë 8.11.2017; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 189, datë 23.11.2017; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2061/1 prot., datë 12.12.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022”,

konstatoi se:

- I licencuari që kërkon përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të shërbimeve të energjisë elektrike dhe të gazit natyror për vitin pasardhës jo më vonë se data 1 shtator të vitit aktual duhet të paraqesë në ERE një kërkesë me shkrim, të shoqëruar me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar në zbatim të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” dhe metodologjive përkatëse.

- Këshilli i Ministrave, me anë të vendimit nr. 584, datë 8.10.2021, të ndryshuar me VKM-në nr. 256, datë 29.4.2022 dhe VKM-në nr. 650, datë 10.10.2022, ka vendosur shpalljen e gjendjes së emergjencës së furnizimit me energji elektrike, e cila i shtrin efektet deri më 30 qershor 2023. Ky vendim ndër të tjera përcakton një sërë detyrash ndaj OSHEE Group, OST sh.a., dhe KESH sh.a., të cilat lidhen me ndryshimet e çmimeve të importit të energjisë elektrike në tregun e lirë dhe sigurimin e furnizimit të pandërprerë të energjisë elektrike për klientët fundorë.

- Lidhur me miratimin e çmimeve me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2023, evidentojmë, se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 74, datë 13.4.2022, ka vendosur se çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për periudhën 1 maj–31 dhjetor 2022 janë ato të miratuara me anë të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 252, datë 21.12.2021, dhe se klientët, të cilët kanë plotësuar kushtet ligjore dhe/ose teknike për daljen në tregun e liberalizuar të energjisë elektrike nuk janë subjekt i parashikimeve të pikës 1 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022.

- ERE, me shkresën nr. 1470 prot., datë 18.8.2022, ka sjellë në vëmendje të shoqërisë FSHU sh.a. detyrimin për të aplikuar për përcaktimin e çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët fundorë, që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, në përputhje me nenin 5, pika 3, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të Klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal”, dhe nenin 21 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”.

- Shoqëria FSHU sh.a. nuk ka paraqitur pranë ERE-s aplikim për miratimin e çmimeve me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2023, bazuar në detyrimet sipas legjislacionit në fuqi.

- Në mënyrë që shoqëria FSHU sh.a., edhe për vitin 2022, të mund të realizojë aktivitetin për të cilit është licencuar, konform ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, bëhet e domosdoshme të vijojë faturimin bazuar në çmimet e miratuara nga ERE.

- Shoqëria FSHU sh.a. duhet të përcjellë në ERE kostot dhe të ardhurat faktike të aktivitetit të Furnizimit të Shërbimit Universal të energjisë elektrike për vitin 2021 dhe vitin 2022, si dhe të marrë masa për plotësimin e kërkesave dhe të dispozitave të akteve ligjore dhe rregullatore në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë FSHU sh.a. për vitin 2023, për çmimet me pakicë për klientët fundorë, që shërbejnë nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, ose konstatimit të ndryshimit të kostove bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e shoqërive do të bëhet korigjimi dhe kompensimi përkatës i tyre, në përputhje me përcaktimet e nenit 20, germa “c”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe metodologjive përkatëse, të miratuara nga ERE.

3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti